

Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë kompetente për ushtrimin e ndjekjes penale, DUKE PËRJASHTUAR rastet e mëposhtme për të cilat është kompetente Prokuroria e Posaçme:

- 1) Krimet si vijon:
 - **Veprat penale të terrorizmit** parashikuar në nenet: 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b;
 - **Vepra të korrupsionit** parashikuar në nenet: 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, **328 dhe 328/b të Kodit Penal;**
- 2) Çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;
- 3) Akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;
- 4) Akuzat penale kundër ish-funksionarëve të pikës 3, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

PROKURORITË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

